



**Shtoja 2: UDHËZUES PËR KRITERET TEKNIKE MINIMALE**

Varësisht nga pozicionet e para-aprovuara, materialet që duhet të vendosen duhet të plotësojnë karakteristikat:

1. Termoizolimi i mureve të jashtme me  $t \geq 12$  cm  
Termoizolimi i mureve të jashtme me EPS,  $t \geq 12$  cm, me densitet  $\rho \geq 18 \text{ kg/m}^3$ , minimumi i përcueshmërisë termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ . Klasa e rezistencës ndaj zjarrit të jetë sipas EN13501 si dhe
2. Termoizolimi i mureve të cokllës me XPS,  $t \geq 10\text{cm}$ ,  $h \leq 40 \text{ cm}$  nga niveli i tokës; densiteti  $\rho \geq 35 \text{ kg/m}^3$ , minimumi i përcueshmërisë termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ , klasa e rezistencës ndaj zjarrit të jetë sipas EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve të vendosura ne BoQ.
3. Termoizolimi i konzolave (pllakat, ballkonet, streha e hyrjeve) në kontakt me ajrin e jashtëm dhe i kornizës se kulmit. Termoizolimi i konzolave (pllakat, ballkonet, streha e hyrjeve) në kontakt me ajrin e jashtëm dhe i kornizës së kulmit me EPS  $t \geq 5\text{cm}$ , me densitet  $\rho \geq 18 \text{ kg/m}^3$ , minimumi i përcueshmërisë termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ , klasa e rezistencës ndaj zjarrit të jetë sipas EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve të vendosura në BoQ.
4. Ndërrimi i drifareve, dyerve të tarracës dhe derës së hyrjes  
Ndërrimi i drifareve të jashtme dhe dyerve të tarracës ekzistues me të rejet nga PVC me këto karakteristika: Korniza e profilit me trashësi se paku  $b/h = 80/80 \text{ mm}$  dhe minimum 6 fusha termike dhe tre goma/dihtunga
  - Xhami i dyfishtë 4+16+4 mm, i mbushur me argon dhe xham Low "E" nga ana e brendshme
  - Mekanizmi mbyllës me kualitet të lartë sipas DIN, EN, ISO
  - Koeficienti i transmetimit të nxehësisë,  $U \leq 1.4 \text{ W/m}^2\text{K}$  dhe çdo element tjetër sipas kritereve te vendosura ne BoQ.
5. Termoizolimi i kulmit të pjerrët - kulmi i ngrëjtë/që shfrytëzohet dhe i pllakës nën kulm/kulmi i ftohtë Termoizolimi me lesh guri, me trashësi  $t \geq 15 \text{ cm}$ , me densitet  $\rho \geq 40 \text{ kg/m}^3$ , përcueshmëria termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ . Klasa e rezistencës ndaj zjarrit Euroclass A1 sipas EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve te vendosura ne BoQ.
6. Termoizolimi i kulmit të rrafshët dhe i tarracës mbi hapësirën e ngrohur  
Termoizolimi i kulmit të rrafshët dhe i tarracës mbi hapësirën e ngrohur me XPS  $t \geq 15 \text{ cm}$ , densitet  $\rho \geq 35 \text{ kg/m}^3$ , përcueshmëria termike:  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ , rezistenca në presion/shtypje në 10% deformim kPa CS (10 Y) 250, rezistenca ndaj zjarrit sipas EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve të vendosura ne BoQ.
7. Termoizolimi i mureve të atikes EPS  $t \geq 5 \text{ cm}$   
Termoizolimi i mureve të atikes EPS  $t \geq 5 \text{ cm}$ , densitet  $\rho \geq 18 \text{ kg/m}^3$ , përcueshmëria termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ . Klasa e rezistencës ndaj zjarrit EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve të vendosura ne BoQ.
8. Termoizolimi i tavantit të bodrumit/përdheses së pa ngrohur  
Termoizolimi i plafonit të bodrumit/përdheses së pa ngrohur me EPS  $t \geq 12 \text{ cm}$ , densitet  $\rho \geq 18 \text{ kg/m}^3$ , përcueshmëria termike  $\lambda \leq 0.04 \text{ W/mK}$ . Klasa e rezistencës ndaj zjarrit sipas EN13501 dhe çdo element tjetër sipas kritereve te vendosura ne BoQ.

Çdo material tjetër i përdorur duhet te plotësojë kriteret teknike sipas pozicioneve përkatëse. Pavarësisht nga kjo, subvencionimi nga FKEE do të bëhet për çmimin referent të materialit të propozuar dhe me të gjitha pjesët përcjellëse sipas paramasës dhe paralogarisë.